**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2244/14 prot. Datë 02.10.2025

**V E N D I M**
**Nr. 1375/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 02.10.2025 u shqyrtua ankesa me

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK, në procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar"*, me Nr.REF-20140-09-17-2024, me objekt: "*Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve*", me fond limit 144.043.333,3 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

**Autoriteti Kontraktor:** Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a, me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

**Ankimues:** BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK, përkatësisht me NUIS L42202028V dhe NUIS L82210031Q, me adresë:
Njesia Administrative Nr. 5, Rr. Nikolla Tupe , Nd.4, H.3, Ap.13, Ap.14, Tirane.

| | |
|---|---|
| **Baza Ligjore:** | Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*". |

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. BOE ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.09.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit "*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*", me Nr. REF-20140-09-17-2024, me objekt: "*Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve*", me fond limit 144.043.333,3 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.12.2024nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë SH.A.

II.2. Në datën 17.07.2025 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

1. "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK 107.266.000 lekë, skualifikuar
2. "Prisma" SHPK & "Kreatx" SHPK& "Jehona Soft" SHPK 118.880.000 lekë, kualifikuar

BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK nga KVO-ja, është njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

*"Oferta e paraqitur nga BOE Primus Albania sh.p.k & Nexia Al Consulting sh.p.k me vlerë 107.266.000(njeqid e shtate milion e dyqind e gjashtedhjete e gjashte mije ) lekë pa tvsh. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", VKM-së nr.285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar neni 82 si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik nga të cilët rezulton si më poshtë vijon*

***Së pari*** *AK në dokumentat standarte të tenderit ka kerkuar si më poshtë vijon: Shtojca 9 (Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT I.*

*Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________ të operatorit ekonomik ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që: A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik Identifikimi Përgjigjja Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE ---------------------------------------------- Numri NIPT/et: ------------------------ ---------------------------- Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar -----------------a---------------- ---------------------- Përfaqësuesi (emri): -------------------------------------------- Telefoni: --------- -------------------------------------------- E-mail: -------------------------------------------------------*

*B: DEKLARATË Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)*

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

*• Informacione për nënkontraktorin Emri i nënkontraktorit të propozuar NIPT –i Përqindja e nënkontraktimit Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar*

*• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik Emri (at) e subjekteve NIPT-i Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik Specifiko konkretisht kapacitetin/et*

*Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT*

*Deklarata Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme ___________________________________________*
*Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme__________________________________*
*Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese,,vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme__________________________________________*
*Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme____________________________________________*
*Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme____________________________________*
*Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme__________________________________________*
*Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme____________________________________________*
*Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.*
*Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme ___________________________________________*
*B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura.*
*Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:*

*1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
*2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
*3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
*4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
*5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*
*6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme): a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; ¬ b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). ¬*
*7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me: a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose, d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*
*8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*
*9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b). C: DEKLARATA Mbi Konfliktin e Interesit Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt*

*nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005). Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit. Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.*

*D: DEKLARATA Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Deklarata*

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

*• Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. • Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. • Operatori ekonomik*

*________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme ____________________________________________.*

*Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit A: DEKLARATË Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës: Deklarata Përgjigje Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. Po [ ] Jo [ ] B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) Deklarata Përgjigje Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. Punonjës Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve:*

*Profili i punonjësve ________________________________________ Makineri e mjete Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:*

*Emri, Mbiemri________________ Firma ________________________*

*Vula________________________ Data e dorëzimit të deklaratës ______________ Ju lutemi sigurohuni që:*

*- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit. - Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. - Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik. - Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër. - Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. - Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*Komisioni i vleresimit te ofertave gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik pjesmarres konstaton se: OE "Primus Albania" nuk ka plotesuar sipas parashikimeve ligjore Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit pasi ne seksionin e meposhtem :"Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese,,vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë etj.nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPPsë, etj."sepse ne kete seksion te Formularit te Vetedeklarimit nuk ka vetedeklaruar personin Denisa Sala e cila eshte ne rolin e drejtores ekzekutive dhe ka kompetenca perfaqesuese. Personi Denisa Sala e vertetuar me dokumentacionin e ngarkuar ne SPE del ne pah si individ i cili ka kompetenca perfaqesuese pasi eshte personi i cili firmos Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit ne emer dhe per llogari te administratorit te OE Primus Albania. Fakti qe personi Denisa Sala ka kompetenca perfaqesuese konstatohet gjithashtu dhe ne marreveshjen e bashkepunimit te nenshkruar ndermjet OE "Primus Albania" Shpk dhe OE "Nexial Al Consulting" shpk ku dallohet qarte qe kjo marreveshje eshte firmosur per OE Primus Albania Shpk nga Denisa Sala ne cilesine e perfaqesueses. Nje konfimim tjeter qe personi Denisa Sala ka kompetenca sipas parashikimeve ne seksionin e mesiperm eshte dhe fakti se ne te gjitha ankesat qe ka patur per kete procedure nga ana e opertorit ekonomik "Primus Albania"shpk jane nenshkruar elektronikisht nga personi Denisa Sala. Pra nga te gjitha parashtrimet e mesiperme del ne pah qe personi Denisa Sala eshte ne cilesine e parashikimeve te seksionit te mesiperm pasi eshte person i cili ka kompetenca perfaqesuese brenda operatorit ekonomik dhe eshte detyrim deklarimi i saj ne formular te vetedeklarimit.*

*Gjithashtu OE "Primus Albania" shpk nuk ka plotesuar sipas parashikimeve ligjore Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit pasi ne seksionin: "Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese,,vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshte etj.nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPPsë, etj." ka dhënë informacion vetëm për personat në cilësinë e kërkuar nga rubrika përkatëse por jo për dokumentacionin apo institucionin ku mund të kryhet verifikimi i këtij informacioni ndersa ne seksionin "Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi" nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi. Ne mbeshtetje te ketij konstatimi na vjen ne ndihme vendimi unifikues i KPP Nr. 1144/2024 ne baze te se cilit KPP ka mbajtur qendrimin e qarte qe Formulari Permbledhes I Vetedeklarimit duhet plotesuar ne te gjithas seksionet e saj ku do te qartesoje dokumentacionin apo institucionin ku mund te kryhet verifikimi.*

*OE "Nexia Al Consulting" shpk nuk ka plotesuar sipas parashikimeve ligjore Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit pasi ne seksionin: "Personi / personat në cilësinë e anëtarit të*

*organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese,,vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshte etj.nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj." ka dhënë informacion vetëm për personat në cilësinë e kërkuar nga rubrika përkatëse por jo për dokumentacionin apo institucionin ku mund të kryhet verifikimi i këtij informacioni, ndersa ne seksionin "Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi" nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi. Ne mbeshtetje te ketij konstatimi na vjen ne ndihme vendimi unifikues i KPP Nr. 1144/2024 ne baze te se cilit KPP ka mbajtur qendrimin e qarte qe Formulari Permbledhes I Vetedeklarimit duhet plotesuar ne te gjithas seksionet e saj ku do te qartesoje dokumentacionin apo institucionin ku mund te kryhet verifikimi. Gjithashtu Bashkimi i operatoreve ekonomik "Nexia Al Consulting"sh.p.k dhe " Primus Albania" sh.p.k nuk kane plotesuar sipas parashikimeve ligjore Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit pasi ne seksionin: Emri i operatorit ekonomik:(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE nuk kane plotesuar emrat e bashkimi te operatoreve ekonomik si rolin qe kane ne kete marreveshje bashkepunimi.*

***Së dyti*** *AK në dokumentat standarte te tenderit ne kriteret e vecanta te kualifikimi perkatesisht ne piken 2.3 ka kerkuar si me poshte:*

*2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:*

*2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 57.617.333,32 (pesedhjete e shtate milion e gjashteqind e shtatembedhjete mije e treqind e tridhjete e tre presje tridhjete e dy) lekë pa tvsh. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe te deklaruara ne orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara, b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

*Komisioni i vleresimit te ofertave gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik pjesmarres konstaton se:*

<u>*OE "Nexia Al Consulting" shpk me dokumentacionin e ngarkuar ne SPE nuk verteton se permbush kriterin 2.3.1 per pervojen e ngjashme*</u>*. Po ti referohemi marreveshjes se bashkepunimit te ngarkuar ne SPE nga BOE konstatojme qe OE "Nexia Al Consulting" shpk ka marre persiper te*

*kryeje sipas perqindjes sherbimet "Përmirësimi dhe Përshtatja e Sistemit të Faturimit Al-Billing(ose ekuivalent)", "Oracle Database Enterprise Edition (Processor License, së bashku me shërbimin e Partitioning) ose ekuivalente, përfshirë shërbimet që lidhen me zbatimin dhe migrimin, dhe shërbimet e replikimit online me bazën e të dhënave Cloud", "Sistemim i auditimit të bazave të të dhënave Oracle si Core Audit Application (Processor License) ose ekuivalente, " Server cloud së bashku me mbrotjen e të dhënave, për zbatimin e komponenteve online me bankat si dhe me klientet", "Bazë e të dhënave të hostura Oracle e integruar me bazën e të dhënave në on-premise (vite)", "Mirëmbajtje dhe garanci prodhuesi per Sistemit të Faturimit Al-Billing(ose ekuivalent), Reader, Taksa dhe ËS të pagesave, bazat e te dhenave enterprise edition, particionimit, core audit".*

*Po ti referohemi dokumentacionit te ngarkuar ne SPE ne permbushje te kriterit 2.3.1 te kritereve te vencanta te kualifikimit nga BOE ne asnje moment nuk arrihet qe te verifikohet ngjashmeria e pervojes se "Nexia Al Consulting" shpk me zerat qe ka marre persiper te kryeje gjate zbatimit te kontrates. Keto referenca nuk perputhen ne vlere si dhe te sherbime.*

*Me konkrerisht:*

*- Lidhur me referencat e shoqerise OE "Nexial Al Consluting", te gjitha referencat (referuar faturave te dorezuara dhe te permbledhura ne dokumentin permbledhes te faturave) konsitojne ne sherbime qe lidhen me **"Billy Bridge Paketa" ose "Shërbim Fiskalizimi"** dhe per kete jashte detyrave per te cilat OE merr persipër, referuar kontrates se bashkepunmit (me konkretisht. Permiresim apo pershtatje Sistem Faturimi, Sistem Administrimi te leximeve dhe Taksave, Oracle Database, Core Audit, Server cloud, Baze te dhenash te hostuara Oracle apo ekuivalente).*

*Gjejme me vend te theksojme se sherbimi i fiskalizimit (ku konsistojne sherbimet e referuara ne oferten e OE) nuk jane pjese e sherbimeve te kesaj kontrate.*

*Si rrjedhoje asnje reference NUK eshte e vlefshme, ose ka nje mase te referencave te vlefshme 0 lek ne kundershtim me detyrimin minimal prej 11,523,466.6 Leke (referuar ndarjes se detyrave dhe perqindjeve te pjesmarrjes ne Kontraten e Bashkepunimit).*

*- Gjithashtu <u>OE Primus Albania,</u> nje pjese e referencave (referuar faturave te dorezuara dhe te permbledhura ne dokumentin permbledhes te faturave) nuk perputhen qe qellimin e sherbimeve pjese te kontrates, apo detyrave per te cilat OE merr persier referuar kontrates se bashkepunimit (Permiresim apo pershtatje Sistem Faturimi, Sistem Administrimi te leximeve dhe Taksave, Permiresimi dhe implementimi i sherbimit te pagesave, Permiresimi dhe Implementimi i Sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA, Oracle Database, Core Audit, Baze te dhenash te hostuara Oracle apo ekuivalente, Sistemi i hostuar i raportimit BI). Me konkretisht, referencat:*

*- Faturat e leshuara drejt kompanise Nexia AL Consulting me vlere totale prej 17,938,302 Leke, jane "Asistence per sherbime IT dhe Netëork" nuk perputhet me objektin e kontrates.*

*- Fatura e leshuar drejt kompanise "OSA Racunarski inzenjering d.o.o." me vlere 18,147,000 Leke, eshte per sherbimet "Soft ser XML format of Finan.Doc,stand. EN 16931-1" dhe "Tech. and develop. documentation ëith source", jashte objektit te kesaj procedure. Nderkohe qe faturimi elektronik theksojme se eshte jashte qellimit te kesaj kontrate.*

*- Fatura e leshuar drejt kompanise "The PLAZA Tirana" me Nr. Fature 117/2021, vlere 1,898,037.44 Leke, eshte per sherbimet "Sherbim implementimi sipas kontrates", duke mos pasur informacionin se cfare perfshin kontrata.*

*Si rrjedhoje referenca te puneve te ngjashme plotesohet ne masen nen 16,000,000 Leke ne kundershtim me detyrimin minimal prej 46,093,866.4 Leke (referuar ndarjes se detyrave dhe perqindjeve te pjesmarrjes ne Kontraten e Bashkepunimit).*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3 të nenit 92, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" si dhe pikës 2 të nenit 82, Kreu X të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit."*

***Së treti:** AK ne dokumentat standarte te tenderit ne kriteret e vecanta te kualifikimit perkatesisht ne piken 2.8 ka kerkuar si me poshtë: 2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, lidhur me produktet softëare te gatshem duhet të paraqesë Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik per produktet standarde te ofruara si database, partitioning, Audit Log, Sistem BI, Sistemi i leximeve, etj); Gjithashtu App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundit nga dita e shpalljes se kesaj procedure.*

*Komisioni i vleresimit te ofertave gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik pjesmarres konstaton se:BOE nuk ka permbushur kriterin 2.8 nenpika e cila thote "Gjithashtu App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundit nga dita e shpalljes se kesaj procedure", pasi gjate verifikimit te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE nuk konstatohet qe te jete ngarkuar certifikata e cila te konfirmoje qe APP Mobile i zgjidhjes se ofruar te eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3 të nenit 92, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" si dhe pikës 2 të nenit 82, Kreu X të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit."*

II.3. Në datën 12.08.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE.

II.4. Në datën 20.08.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5711, protokolluar me nr. 2244/2025 protokolli, datë 20.08.2025, e BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK, për procedurën e prokurimit *Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*", me Nr. REF-20140-09-17-2024, me objekt "*Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve*",

me fond limit 144.043.333,3 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

"*Argumentime mbi shkeljet e pretenduara*

*Referuar gjetjeve/pretendimeve të KVO evidentuar në FNS, më poshtë po ju parashtrojmë faktet dhe argumentet tona me anë të cilave hedhim poshtë vendimin e KVO për skualifkimin e ofertës të OE, Primus Albania sh.p.k. dhe Nexia Al Consulting sh.p.k.*
*Me tekst të zi janë gjetjet/ pretendimet e KOV dhe me blu janë faktet dhe argumentet tona.*
*Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:*
*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, ìPër Prokurimin Publik", VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar neni 82 si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik nga të cilët rezulton si më poshtë vijon*
***Së pari** AK në dokumentat standarte të tenderit ka kerkuar si më poshtë vijon:*
*Shtojca 9*
*(shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*
*FORMULARI PERMBLEDHES I VETEDEKLARIMIT*
*II. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________ të operatorit*
*Ekonomik _______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:*
*B. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik*
*Identifikimi Përgjigjja*
*Emri i operatorit ekonomik:*
*(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE ------------------------------------------------*
*Numri NIPT/et:-----------------------------------------------------*
*Adresa postare:*
*Qyteti / qyteti; Kodi postar -----------------a-------------------------------------*
*Përfaqësuesi (emri): -------------------------------------------*
*Telefoni: ----------------------------------------------------*
*E-mail:-------------------------------------------------------*
*B: DEKLARATE*

*Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatorin Ekonomik*
*(nëse është e zbatueshme)*
*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*
*? Informacione për nënkontraktorin*
*Emri i nënkontraktorit të propozuar NIPT -i përqindja e nënkontraktimit Mallrat/Shërbimet e lidhura me to për tíu nënkontraktuar*
*? Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*
*Emri (at) e subjekteve NIPT-i Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik*
*Specifiko konkretisht kapacitetin/et*
*Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit*
*A: DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT*
*Deklarata*
*Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posacëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

____________________________________________________

*Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjecare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*________________________________________
*Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si Aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese,,vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit ekonomik, si më poshtë:*
*etj.*
*Nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjecare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*__________________________________________________
*Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*__________________________________________________
*Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*__________________________________________________
*Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*________________________________________________

*Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.*

*Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*________________________________________________

*Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

*Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.*

*Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________

*B: DEKLARATA*

*Për dorëzimin e Ofertave të Pavarura*

*Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në cdo aspekt:*

*10. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*

*11. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të síkualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në cdo aspekt;*

*12. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*

*13. Cdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*

*14. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "Konkurrentë" nënkupton cdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*

*C) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të kontratës dhe/ose të ftesës për ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*

*D) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të kontratës dhe/ose të ftesës për ofertë.*

*15. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

*A) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; ?*

*B) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*
*?*
*16. Në vecanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*
*E) Cmimet;*
*F) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e cmimit;*
*G) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
*H) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*
*17. Përvec kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veáanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveá se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. B).*
*18. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do túu bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në cdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*
*C: DEKLARATA*
*Mbi Konfliktin e Interesit*
*Deklarata*
*Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:*
*Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.*
*Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siá parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:*
*- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe*

*cdo zyrtar publik në cdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.*
*Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të Zyrtarit, sic përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.*
*Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).*
*Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.*
*Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike , të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik.*
*Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, sic përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.*
*D: DEKLARATA*
*Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës*
*Deklarata*
*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*
*Ju bëjmë me dije se angazhimi kryesor i Primus Albania sh.p.k, që nga Korriku 2016, ka qënë ofrimi i programit kompjuterik Al-Billing, përmirësimi dhe mirëmbajtja e tij (të cilin UK TR ka sot në përdorim dhe për të cilin kërkon shërbimet) dhe është padyshim e perfeksionuar si ofruese e këtij shërbimi në shumë prej ujësjellësave në mbarë vendin. Këtë e vërtetojnë edhe vërtetimet e realizimit të kontratave si për programin Al-Billing ashtu edhe për pajisje PDA.*
*Për të vertëtuar shërbimet e kryera dhe referuar kërkesave të mësipërme, Primus Albania sh.p.k. ka paraqitur vërtetimet dhe faturat tatimore në rastin e shërbimeve në sektorin publik dhe faturat tatimore të shitjes në rastin e sektorit privat.*
*Përmbledhje e faturave të ngarkuara në sistemin SPE të APP do ta gjeni në tabelat e meposhtme, informacion të cilin e kemi ngarkuar edhe në SPE të APP, krahas vërtetimeve të realizimit dhe faturave tatimore.*
*Permbledhje e Faturave dhe Referencave per Primus Albania sh.p.k.*
*UK Berat-Kucove / nr. 883, dt. 25.07.2020*
*Vlera 6,620,000 Lek*

*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*123 21.10.2021 (45,000.00)*
*124 27.10.2021 (45,000.00)*
*125 27.10.2021 45,000.00*
*136 01.11.2021 45,000.00*
*175 11.12.2021 (45,000.00)*
*176 11.12.2021 (45,000.00)*
*29 02.02.2022 270,000.00*
*87 04.04.2022 270,000.00*
*450,000.00*
*SHR UK Berat / nr. 973, dt. 23.09.2024*
*Vlera 540,0000 Lek*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*277 08.11.2022 56,250.00*
*302 01.12.2022 45,000.00*
*324 27.12.2022 45,000.00*
*18 10.02.2023 45,000.00*
*23 07.03.2023 45,000.00*
*34 03.04.2023 45,000.00*
*54 08.05.2023 45,000.00*
*68 01.06.2023 45,000.00*
*83 07.07.2023 45,000.00*
*89 04.08.2023 45,000.00*
*101 31.08.2023 45,000.00*
*117 03.10.2023 33,750.00*
*540,000.00*
*UK Lushnje / nr. 640/6 dt. 27.06.2020*
*Vlera 5,120,000 Lek*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*113 05.10.2021 47,500.00*
*138 01.11.2021 47,500.00*
*140 03.11.2021 47,500.00*
*158 03.12.2021 47,500.00*
*13 06.01.2022 47,500.00*
*30 02.02.2022 47,500.00*
*58 07.03.2022 47,500.00*
*84 04.04.2022 47,500.00*
*112 04.05.2022 47,500.00*
*144 31.05.2022 47,500.00*
*169 01.07.2022 47,500.00*

*189 02.08.2022 47,500.00*
*570,000.00*
*UK Fier / nr. 1209 dt. 07.05.2022*
*Vlera 750,000 Lek*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*114 05.10.2021 62,500.00*
*139 01.11.2021 62,500.00*
*159 03.12.2021 62,500.00*
*14 06.01.2022 62,500.00*
*31 02.02.2022 62,500.00*
*59 07.03.2022 62,500.00*
*85 04.04.2022 62,500.00*
*114 05.05.2022 62,500.00*
*115 05.05.2022 125,000.00*
*625,000.00*
*SHRUK Fier / nr. 01/1 dt. 11.01.2023*
*Vlera 6,590,000 Lek*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*16 10.02.2023 1,890,000.00*
*30 17.03.2023 3,940,000.00*
*50 26.04.2023 760,000.00*
*6,590,000.00*
*UK Roskovec / 13.08.2022*
*Vlera 424,400 Lek*
*Nr. Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*44 18.08.2021 422,400.00*
*422,400.00*
*UK Mat / 01.07.2022*
*Vlera 360,060 Lek*
*Nr. Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*134 01.11.2021 60,010.00*
*155 03.12.2021 60,010.00*
*10 06.01.2022 60,010.00*
*180,030.00*
*UK Tepelene/ nr. 203 dt. 01.07.2021*
*Vlera 302,160 Lek*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*27 06.08.2021 25,180.00*
*74 07.09.2021 25,180.00*
*107 05.10.2021 25,180.00*

*132 01.11.2021 25,180.00*
*153 03.12.2021 25,180.00*
*8 06.01.2022 25,180.00*
*25 02.02.2022 25,180.00*
*54 07.03.2022 25,180.00*
*80 04.04.2022 25,180.00*
*108 04.05.2022 25,180.00*
*140 31.05.2022 25,180.00*
*165 30.06.2022 25,180.00*
*302,160.00*
*UK Tepelene/ dt 01.07.2022*
*Vlera 282,000 Lek*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*185 02.08.2022 23,500.00*
*217 02.09.2022 23,500.00*
*245 03.10.2022 23,500.00*
*272 08.11.2022 23,500.00*
*297 01.12.2022 23,500.00*
*320 27.12.2022 23,500.00*
*141,000.00*
*Hotal Plaza*
*Nr. Fat Data Fat Vlera e Fat pa TVSH*
*117 06.10.2021 1,898,037.44*
*15 07.01.2022 14,785.18*
*32 02.02.2022 14,793.72*
*61 07.03.2022 15,198.76*
*88 06.04.2022 14,808.36*
*119 05.05.2022 14,709.54*
*142 05.11.2021 14,986.48*
*145 03.12.2021 14,780.30*
*147 31.05.2022 14,731.50*
*173 01.07.2022 14,533.86*
*195 02.08.2022 14,247.16*
*208 02.09.2022 14,372.82*
*252 07.10.2022 14,299.62*
*100 22.08.2023 103,475.00*
*113 18.09.2023 37,236.50*
*115 27.09.2023 12,993.00*
*129 01.11.2023 12,872.00*
*147 04.12.2023 12,343.00*

*4 08.01.2024 12,738.00*
*15 06.02.2024 12,704.90*
*51 09.03.2024 12,674.58*
*59 05.04.2024 12,506.72*
*83 07.05.2024 12,273.20*
*99 07.06.2024 12,244.92*
*124 10.07.2024 12,239.04*
*130 09.08.2024 12,220.52*
*142 09.09.2024 12,166.84*
*159 09.10.2024 12,051.16*
*2,377,024.12*
*Nexia Al Consulting sh.p.k.*
*Nr. Fat Data Fat Vlera e Fat pa TVSH*
*121 21.10.2021 900,000.00*
*172 20.12.2021 480,000.00*
*130 10.05.2022 624,800.00*
*131 10.05.2022 1,710,380.00*
*203 24.08.2022 1,250,000.00*
*265 01.11.2022 600,000.00*
*291 30.11.2022 600,000.00*
*329 29.12.2022 600,000.00*
*11 09.02.2023 600,000.00*
*62 24.05.2023 382,674.00*
*63 24.05.2023 (382,674.00)*
*64 24.05.2023 416,200.00*
*85 13.07.2023 1,000,000.00*
*108 07.09.2023 2,000,000.00*
*125 27.10.2023 1,000,000.00*
*159 26.12.2023 1,000,000.00*
*82 02.05.2024 1,500,000.00*
*94 14.05.2024 656,922.00*
*112 02.07.2024 1,000,000.00*
*141 04.09.2024 1,000,000.00*
*171 04.11.2024 1,000,000.00*
*17,938,302.00*
*AK - Invest*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*34 02.02.2022 57,245.00*
*35 02.02.2022 25,042.50*
*36 02.02.2022 (57,245.00)*

*37 02.02.2022 27,312.50*
*62 07.03.2022 20,765.00*
*71 24.03.2022 24,502.50*
*72 24.03.2022 26,042.50*
*89 06.04.2022 25,182.50*
*97 11.04.2022 23,647.50*
*132 10.05.2022 23,350.00*
*153 10.06.2022 23,190.00*
*178 06.07.2022 15,425.50*
*197 05.08.2022 14,390.00*
*228 09.09.2022 1,552.50*
*259 24.10.2022 13,972.50*
*285 30.11.2022 13,480.00*
*326 28.12.2022 13,410.00*
*291,265.50*
*4 09.01.2023 14,425.00*
*14 10.02.2023 14,825.00*
*27 10.03.2023 13,352.50*
*45 07.04.2023 15,847.50*
*56 09.05.2023 14,937.50*
*70 07.06.2023 13,270.00*
*78 05.07.2023 14,005.00*
*96 10.08.2023 12,465.00*
*106 07.09.2023 12,302.50*
*110 11.09.2023 33,682.50*
*111 11.09.2023 (33,682.50)*
*121 09.10.2023 11,552.50*
*135 06.11.2023 11,847.50*
*148 08.12.2023 11,685.00*
*160,515.00*
*5 08.01.2024 11,252.50*
*28 10.02.2024 11,830.00*
*48 09.03.2024 10,777.50*
*72 10.04.2024 11,577.50*
*87 10.05.2024 11,670.00*
*102 07.06.2024 12,760.00*
*122 10.07.2024 11,685.00*
*133 09.08.2024 12,965.00*
*146 09.09.2024 13,295.00*
*160 09.10.2024 12,735.00*

*120,547.50*
*572,328.00*
*EasyPay*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*160 03.12.2021 31,647.50*
*168 09.12.2021 30,690.00*
*62,337.50*
*91 07.04.2022 30,535.00*
*121 09.05.2022 31,402.50*
*151 09.06.2022 30,202.50*
*177 06.07.2022 18,832.50*
*230 09.09.2022 17,995.00*
*256 10.10.2022 17,920.00*
*287 30.11.2022 17,955.00*
*164,842.50*
*3 09.01.2023 17,897.50*
*6 10.01.2023 19,815.00*
*13 10.02.2023 19,500.00*
*25 08.03.2023 17,690.00*
*44 07.04.2023 22,265.00*
*61 10.05.2023 22,160.00*
*71 08.06.2023 19,200.00*
*82 06.07.2023 19,737.50*
*92 10.08.2023 19,755.00*
*109 08.09.2023 16,832.50*
*119 06.10.2023 19,352.50*
*134 06.11.2023 17,162.50*
*154 09.12.2023 15,980.00*
*247,347.50*
*3 08.01.2024 17,225.00*
*29 10.02.2024 18,097.50*
*49 09.03.2023 16,317.50*
*71 10.04.2024 17,610.00*
*69,250.00*
*481,440.00*
*RAEA*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*33 20.02.2024 107,275.00*
*52 09.03.2024 1,712.50*
*74 10.04.2024 2,475.00*

*85 10.05.2024 2,122.50*
*100 07.06.2024 3,427.50*
*126 10.07.2024 4,237.50*
*131 09.08.2024 4,977.50*
*144 09.09.2024 4,820.00*
*163 09.10.2024 4,712.50*
*135,760.00*
*Unioni Financiar TR*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*162 03.12.2021 55,610.00*
*55,610.00*
*69 24.03.2022 163,882.50*
*70 24.03.2022 96,705.00*
*95 08.04.2022 52,467.50*
*122 09.05.2022 20,220.00*
*127 09.05.2022 (20,220.00)*
*128 09.05.2022 50,550.00*
*150 09.06.2022 51,870.00*
*175 05.07.2022 33,937.50*
*200 09.08.2022 32,235.00*
*229 09.09.2022 37,710.00*
*255 07.10.2022 35,815.00*
*257 10.10.2022 (35,815.00)*
*258 24.10.2022 35,732.50*
*312 27.12.2022 35,202.50*
*590,292.50*
*1 06.01.2023 (35,202.50)*
*2 06.01.2023 35,202.50*
*5 10.01.2023 108,382.50*
*15 10.02.2023 38,147.50*
*26 08.03.2023 35,395.00*
*31 20.03.2023 (35,202.50)*
*46 11.04.2023 41,705.00*
*60 10.05.2023 39,032.50*
*73 09.06.2023 34,977.50*
*81 06.07.2023 34,440.00*
*99 10.08.2023 32,887.50*
*112 11.09.2023 33,682.50*
*120 09.10.2023 32,905.00*
*137 06.11.2023 30,667.50*

*155 09.12.2023 29,365.00*
*456,385.00*
*6 09.01.2024 28,312.50*
*23 09.02.2024 31,712.50*
*47 09.03.2024 28,787.50*
*75 10.04.2024 31,250.00*
*77 11.04.2024 (31,250.00)*
*78 11.04.2024 31,212.50*
*86 10.05.2024 31,355.00*
*101 07.06.2024 32,592.50*
*123 10.07.2024 30,195.00*
*132 09.08.2024 34,420.00*
*136 09.08.2024 (34,420.00)*
*137 09.08.2024 34,322.50*
*145 09.09.2024 33,530.00*
*161 09.10.2024 32,370.00*
*314,390.00*
*1,416,677.50*
*OSA Racunarski Inzenjering d.o.o.*
*Nr Fat Data Fat Vlera Fat pa TVSH*
*100 13.04.2022 18,147,000.00*
*18,147,000.00*
*Pavarësisht se kur është nënshkruar kontrata, në cdo rast janë pasqyruar faturat dhe vlerat e periudhës takuese të kërkuara në DST.*
*Ashtu sic e përcakton ligji dhe lejon teknikisht aplikacioni i plotësimit të faturës të fiskalizuar tatimore, është bërë përshkrimi i përmbledhur i shërbimeve të cdo fature, pavarësisht gamës të gjerë që mund të jetë ofruar në shërbimet e kërkuara. Për informacion të KVO/ AK, moduli i fiskalizimit të faturave në rastin e përshkrimit të objektit të furnzimit/ shërbimit lejon deri në 50 karaktere ku përfshihen gërmat dhe spaciot mes fjalëve. Pra për cdo subjekt do të ishte e pamundur që në faturat e lëshuara të përmendeshin hollësisht të detajuara të gjitha shërbimet periodike mujore të ofruara ashtu siá në rastin konkret pret ti ndeshë në përshkrim KVO ("përmirësimi dhe përshtatja e Sistemit të Faturimit Al-Billing, "Oracle Database Enterprise Edition (Processor License, së bashku me shërbimin e Partitioning), përfshirë shërbimet që lidhen me zbatimin dhe migrimin, dhe shërbimet e replikimit online me bazën e të dhënave Cloud", "Sistemim i auditimit të bazave të të dhënave Oracle si Core Audit Application (Processor License), "Server cloud së bashku me mbrotjen e të dhënave, për zbatimin e komponenteve online me bankat si dhe me klientet", "Bazë e të dhënave të hostura Oracle e integruar me bazën e të dhënave në on-premise", "Mirëmbajtje dhe garanci prodhuesi per Sistemit të Faturimit Al-Billing, Reader, Taksa dhe ËS të pagesave, bazat e te dhenave enterprise edition, particionimit, core audit", etj. etj.*

*Nuk është e qartë se si nga KVO nuk konsiderohen shërbime në fushën e teknologjisë dhe informacionit shërbimet e mëposhtëme që KVO nuk i ka konsideruar si të tilla, pra shërbime të ngjashme dhe jo shërbime të njëjta, shërbimet:*

*Asistence per sherbime IT dhe Netëork ;*

*Soft ser XML format of Finan. Doc, stand. EN 16931-1 dhe Tech. and develop. Documentation ëith source për informacion shërbimi që i ofrohet Hotel Plaza ka të bëjë me furnizimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të biletarisë dhe menaxhimit të parkimit për këtë subjekt.*

*Për të ndihmuar KVO/ AK në njohjen dhe vlerësimin e saktë të faturave po ju bashkëngjisim kontratat me subjektet në sektorin privat, në të cilat janë listuar shërbimet e kryera në ato kontrata:*

*- Kontrata me kompaninë Nexia AL Consulting sh.p.k.;*

*- Kontrata dhe certifikata e pranimit me OSA Racunarski inzenjering d.o.o.;*

*- Kontrata dhe referencë me kompaninë The Plaza Tirana.*

*Në rastet e vërtetimeve të lëshuara nga entet publike është pasqyruar më qartë dhe i detajuar objekti i shërbimeve të kërkuara.*

*Që ju të merrnit një informacion më të plotë për natyrën e detajuar të shërbimeve sic edhe pretendoni, do duhet të ishit shprehur në kriter duke shtuar listën e dokumenteve provues në kërkesat për kualifikim, sic e kërkon VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, pavarësisht se do të ishit të tejkalim të kërkesave të kuadrit ligjor, ose në zbatim të ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 i ndryshuar neni 82 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pika 2, citojmë:*

*2. Në cdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

*Ju mund të kishit kërkuar sqarime dhe dokumente mbështetëse (psh kopje të kontratave) për të arritur në një vendim të drejtë e objektiv.*

*Në këtë kriter ju keni kërkuar "Dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme...". Nëse do të zbërtheni të gjithë elementët kryesorë dhe periferikë të kontratës që prokurohet dhe këto do ti kërkoni në dëshmitë për furnizime të ngjashme atëhere nuk kemi të bëjmë me funrnizime të mëparshme të ngashme por me furnizime të mëparshme të njëjta. Për të bërë verifikimin e përmbushjes të këtij kriteri do të duhej të paraqitej kontrata e plotë e realizuar, gjë që ligjëvënësi nuk e ka parashikuar, referuar termit "e ngjashme".*

*Ndërkohë mqs në SPE të APP është bërë njoftimi për fillimin e procedurës të ankimimit që nënkupton përzgjedhjen e fituesit, një pyetje i bëjmë KVO: Në të gjitha vërtetimet apo faturat fiskale tatimore kompania e përzgjedhur fituese nga ju ka një apo disa nga zërat/ objektivat e shërbimit të kontratës që ju prokuroni? Nëse nuk ka të gjitha zërat/ objektivat e shërbimit të kontratës që ju prokuroni a ja keni zbritur vlerës së faturës vlerat e zërave që mungojnë?*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3 të nenit 92, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" si dhe pikës 2 të nenit 82, Kreu X të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të*

*prokurimit publik" e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

***Së treti:*** *AK ne dokumentat standarte te tenderit ne kriteret e vecanta te kualifikimi perkatesisht ne piken 2.8 ka kerkuar si me poshtë:*

*2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, lidhur me produktet softëare te gatshem duhet të paraqesë materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik per produktet standarde te ofruara si database, partitioning, Audit Log, Sistem BI, Sistemi i leximeve, etj);*

*Gjithashtu App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundit nga dita e shpalljes se kesaj procedure.*

*Komisioni i Vleresimit te Ofertave gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik pjesmarres konstaton se:BOE nuk ka permbushur kriterin 2.8 nenpika e cila thote "Gjithashtu App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundit nga dita e shpalljes se kesaj procedureë, pasi gjate verifikimit te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE nuk konstatohet qe te jete ngarkuar certifikata e cila te konfirmoje qe APP Mobile i zgjidhjes se ofruar te eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi.*

***Sqarim/ kundërshtim**:*

*Për të përmbushur kriterin 2.8 **BOE ka paraqitur katalogë Al Billing - Sistem Menaxhimi Informacioni për ujësjellësa, si dhe Catalog prezantimi Manual përdorimi mbi sistemin: "Js Billing".** Programi kompjutertk i faturimit është i vetmi soft që kërkoni të mirëmbani dhe përmirësoni dhe për këtë ne kemi depozituar katalogët. Softi i PDA është një soft integral i vetë pajisjeve, i cili ashtu sic funksionon sot është kompatibël me programin e faturimit Al-Billing. Në katalogët/ manualët tanë (pasi katalogët shërbejnë përgjithësisht për hardëare dhe softëare) janë përcaktuar qartë ndërtimet dhe funksionimet e tyre, si dhe në vecanti lidhja dhe bashkëveprimi i tyre me sistemet e leximit UK Reader (PDA).*

***App Mobile Ukreader është një aplikacion Android i cili lidhet me Ukreader Ëeb me anë të REST API. Cdo system Android mund të përdorë këtë aplikacion. Duke marrë parasysh që komunikimi kryhet me anë të API me Aplikacionin e hostuar në server on premise dhe App Mobile është një aplikacion i ndërtuar për sistemin Android e bën përdorimin e tij të mundur në një game shumë të gjerë pajisjesh android ose PDA.***

*Përsa më sipër ne si BOE kërkojmë:*

*1. Anullimin e vendimt të KVO-së për refuzimin/ skualifikimin e ofertës të BOE Nexia Al Consulting sh.p.k. Dhe Primus Albania sh.p.k., si një vendim i pambështetur dhe i pabazuar ligjërisht dhe teknikisht*

*2. Rivlerësimin e ofertës të BOE Nexia Al Consulting sh.p.k. Dhe Primus Albania sh.p.k.*

*3. Kthimin e ofertës të BOE Nexia Al Consulting sh.p.k. Dhe Primus Albania sh.p.k. Si një Ofertë që përmbush kriteret e kualifikimit në fazën e vlerësimit elektronik të ofertave dhe mbi të*

*Gjitha si oferta ekonomike më e ulët."*

II.5. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2244/1 Prot., datë 21.08.2025.

II.6. Në datën 21.08.2025 është protokolluar në KPP me nr. 2244/2 prot., ankesa e përsëritur e operatorit ekonomik ankimues, ardhur në Komisionin e Prokurimit Publik nëpërmjet shërbimit postar,

II.7. Në datën 29.08.2025, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2244/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 12217/1 prot., datë 27.08.2025 me objekt: "*Informacion mbi Kthim Përgjigjen ankesës për procedurën e prokurimit me objekt "Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve".* Referuar kësaj shkrese rezulton se ankesa e ankimuesit është refuzuar, duke argumentuar si vijon:
Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit nga KSHA-ja është argumentuar si vijon:
*"[...]*
*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave bazuar sa me siper dhe Sistemin e Prokurimeve Elektronike ju ben me dije se :*
*Në argumentat kundërshtues të paraqitur nge operatori ankimues ne kemi të bejmë më shumë me argumenta narrative dhe jo baze ligjore. Rikujtojmë qe ne bazë te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE nga anëtari i BOE Primus Albania shpk është personi Denisa Sala e cila del ne pah si individ me kompetenca perfaqesuese per shkak te te gjithe dokumentacionit te firmosur nga ana e saj. Vete operatatori ekonomik ankimues e konfirmon ne argumentat e tij qe Denisa Sala ka firmosur cdo dokument, deklarate dhe formular te kesaj procedure si person me kompetenca perfaqesuese. Duke patur parasysh që dokumentacioni i ngarkuar ne SPE eshtë dokumentacion ligjor në vetvete këto mund të nënshkruahen vetëm nga administrator qe eshte perfaqesuesi ligjor i operatorit ekonomik ose nga nje person tjeter i cili e merr kete tager nga administratori. Per nje qartësim sa me te plotë sjellim ne vëmendje qe deklarate ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit parashikon që operatori ekonomik duhet te deklarojë dhe personin qe ka kompetenca përfaqesuese dhe rasti i sipërcituar eshte rast tipik i nje personi me kompetenca perfaqesuese per operatorin ekonomik dhe është detyrimi i OE deklarimi i këtij personi ne formularin permbledhes te vetedeklarimit. Fakti që nuk e ka vetedeklaruar personin Denisa Sala verteton qe formulari permbledhes per kete seksion nuk është plotësuar sipas parashikimeve ligjore. Referuar më shumë seksioneve të vete deklarimit si p.sh në seksionin B Znj. Denisa Sala vetedeklarohet:*
- *Seksioni B, "Ne cilesinë e* ***përfaqesuesit te operatorit*** *...';*

- *Seksioni C 'Ne cilesinë e operatorit ..." si dhe 'Unë jam në dijeni të kerkesave të ligjit ..' si dhe më shumë ne fund te seksionit C përcaktohet ... dhe ne ketë deklarate, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik* ***që unë perfaqësoj këtu****.'*
- *Seksioni D, "****Ne cilesinë e operatorit ekonomik****, deklaroj në përgjegjesine time të plotë*
- *Pjesa III, Seksioni B, "****Ne cilesine e operatorit ekonomik****, deklaroj ne* ***përgjegjësine time te plotë*** *.."*

*Nderkohe verejme qe formulari i vetedeklarimit te OE eshte nenshkruar nga Znj. Sala dhe pa asnje reference autorizimi ose percaktimi te ngjashem.*

*Referuar argumentave per arsyen e skualifikimit sipas se cilës BOE "Primus Albania"Shpk dhe Nexia Albania Consulting" shpk nuk kanë plotesuar Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit me konkretisht seksionin "Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi" sipas parashikimeve ligjore pasi nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi, konstatojme qe dhe ne kete rast argumentat jane narrative dhe te pashoqeruara me fakte dhe prova. Sjellim në vemendje qe plotesimi i formularit permbledhes te vetedeklarimit ne te gjithe seksionet e saj duke dhene adresen ose dokumentin mbi bazen e se ciles autoriteti kontraktor mund te kryeje verifikimet. Përvec vendimit te përmendur nga KVO në arsyen e skualifikimit vlen që të shtojme dhe vendimarrje te mëvonshme të KPP sic janë vendimi Nr.209/2025, datë 07.02.2025 dhe vendimi Nr 816/2025, date 27.06.2025, në te cilet KPP ka konfirmuar që Formulari Permbledhës i Vetedeklarimit duhet të plotësohet ne te gjithë seksionet e saj duke dhënë indicie për institucionin (adresën përkatëse) apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi për këto rubrika.*

*Pretendimet e operatorit ankimues nuk qendrojne dhe per rrjedhoje nuk pranohen."*

Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit nga KSHA-ja është argumentuar si vijon:

*"Anetari i BOE "Nexia Albania Consulting" sh.p.k ka marrë përsiper kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi sipas përqindjes sherbimet Përmirësimi dhe Përshtatja e Sistemit të Faturimit* ***Al-Billing****(ose ekuivalent) ,* ***Oracle Database Enterprise*** *Edition (Processor License, së bashku me shërbimin e Partitioning) ose ekuivalente, përfshirë shërbimet që lidhen me zbatimin dhe migrimin, dhe shërbimet e replikimit online me bazën e të dhënave Cloud ,* ***Sistemim i auditimit të bazave të të dhënave*** *Oracle si Core Audit Application (Processor License) ose ekuivalente,* ***Server cloud*** *së bashku me mbrotjen e të dhënave, për zbatimin e komponenteve online me bankat si dhe me klientet ,* ***Bazë e të dhënave të hostura Oracle*** *e integruar me bazën e të dhënave në on-premise (vite) , Mirëmbajtje dhe garanci prodhuesi per Sistemit të Faturimit Al- Billing(ose ekuivalent), Reader, Taksa dhe ËS të pagesave, bazat e te dhenave enterprise edition, particionimit, core audit, dhe nisur nga ky fakt eshte detyre e operatorit ekonomik qe te plotesoje kriterin per sherbime te ngjashme ne permbushje me perqindjen qe ka marre persiper te kryeje sipas kontrates se bashkepunimit te ngarkuar ne SPE.*

*Nisur nga sherbimet qe Nexia Albania Consulting" shpk ka marrë përsiper te kryeje duhej që për to të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin te procedurës së prokurimit. Rikujtojme qe*

*plotesimi i ngjashmerise eshte kriter thelbesor ne analizimin e dëshmive për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Fakti qe Nexia Albania Consulting" shpk nuk ka paraqitur deshmi per shërbime që të jenë të ngjashme me objektin e prokurimit e ben oferten e BOE te pavlefshme.*

*Referimi nga OE qe sistemi i faturimit eshte i përafert me te fiskalizimit .. nuk ka asnje baze. Sistemi apo sherbimi i fiskalizimit (qe eshte nje sistem i licensuar nga AKSHI si dhe Drejtoria e Tatimeve) ka qellim edhe licensim mire-raportimin e faturave prane serverave te tatimeve (me nje perdorim detyrues ligjor, te pergjithshem per te gjithe shoqerite tregtare per raportimin e faturave) ndersa sistemi i faturimit (lutem referohuni me shume kerkesave funksionale te sistemit) ka nje natyre specifike te shoqerive te ujesjelles kanalizime si leximin, matesat, lexuesit, kontratat, faturimin, kamatvonesat, nderveprimi me shoqerite e pagesave, arketimi, marrëdheniet e klienteles .. etj, etj., funksione/prgrame keto te palicensuara dhe specifike. Kujtojme per me shume, qe qellimi projektit nuk permban funksione qe lidhet me fiskalizimin.*

*Per kete asnje nga referimet e pergjitheshme te shoqerisë Nexia Albania Consulting" shpk, nuk përkojne me asnjë nga fushat per te cilat ajo ofertohet te mbuloje ne BOE, perfshire ketu sistemet e gatshme apo systemin e al-billing.*

*Ne te njejten vlerësim edhe oferta e shoqerisë Primus Sh.p.k eshte reduktuar në masën e projekteve apo sherbimeve te faturimit e qe kane lidhje me ato te shoqërive te ujesjelles kanalizimeve, dhe ne përputhje me komponentet e projektit .. te cilët gjithashtu konsistojne ne Përmirësimi dhe Përshtatja e Sistemit të Faturimit* ***Al-Billing*** *(ose ekuivalent),* ***Oracle Database*** *Enterprise Edition (Processor License, së bashku me shërbimin e* ***Partitioning****) ose ekuivalente, përfshirë shërbimet që lidhen me zbatimin dhe migrimin, dhe shërbimet e replikimit online me bazën e të dhënave Cloud ,* ***Sistemim i auditimit të bazave të të dhënave*** *Oracle si Core Audit Application (Processor License) ose ekuivalente,* ***Server cloud*** *së bashku me mbrotjen e të dhënave, për zbatimin e komponenteve online me bankat si dhe me klientet,* ***Bazë e të dhënave të hostura Oracle*** *e integruar me bazën e të dhënave në on-premise (vite), Mirëmbajtje dhe garanci prodhuesi per Sistemit të Faturimit Al-Bi1ling(ose ekuivalent), Reader, Taksa dhe ËS të pagesave, bazat e te dhenave enterprise edition, particionimit, core audit, etj..*

*Njëkohesisht gjejmë të rëndesishme të verejme se aktiviteti i shoqerisë, Nexia Albania Consulting" shpk (referuar ceriifikimeve ISO .. "Providing business consulting solutions and seëices, specializing in accounting services, business plans, corporate finance, fiscal consulting, legal services, audit & assurance services, company formation and management services as ëell* ***as IT consulting services*** *business. " EA Sector. 35;) është e lidhur me sherbimin e fiskalizimit dhe konsulence ne fushen e IT'se por jo me sherbimet e kerkuara Përmirësimi dhe Përshtatja e Sistemit të Faturimit* ***Al-Billing****(ose ekuivalent),* ***Oracle Database Enterprise*** *Edition (Processor License, së bashku me shërbimin e* ***Partitioning****) ose ekuivalente, përfshirë shërbimet që lidhen me zbatimin dhe migrimin, dhe shërbimet e replikimit online me bazën e të dhënave Cloud ,* ***Sistemim i auditimit të bazave të të dhënave*** *Oracle si Core Audit Application (Processor License) ose ekuivalente,* ***Server cloud*** *së bashku me mbrojtjen e të dhënave, për zbatimin e komponenteve*

*online me bankat si dhe me klientet, **Bazë e të dhënave të hostura** Oracle e integruar me bazën e të dhënave në on-premise (vite) , Mirëmbaj{je dhe garanci prodhuesi per Sistemit të Faturimit Al-Billing(ose ekuivalent), Reader, Taksa dhe ËS të pagesave, bazat e te dhenave enterprise edition, particionimit, core audit, etj.*
*Pretendimet e operatorit ankimues nuk qëndrojnë dhe per rrjedhoje nuk pranohen."*

Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit nga KSHA-ja është argumentuar si vijon:

*"Referuar argumenteve te paraqitur ne ankesë nga operatori ekonomik ankimues dhe dokumentacionit te ngarkuar ne SPE lehtesisht konstatohet qe OE nuk ka paraqitur dokumentacionin e parashikuar ne kriterin 2.8. Ne nje analize dhe shtjellim te kriterit 2.8 "Operatori ekonomik pjesëmarres, lidhur me produktet softeare te gatshem duhet te paraqese materiale teknike te prodhuesit (katalog teknik per produktet standarde te ofruara si **database, partitioning, Audit Log, Sistem BI, Sistemi i leximeve**, etj). Gjithashtu App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtaishem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundii nga dita e shpalljes se kesaj procedure". Qartësisht konstatohet qe ky kriter permbushet me paraqitjen ne SPE te dokumentave si më poshte:*
*- Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik për produktet standarde të ofruara si database, partitioning, Audit Log, Sistem BI, Sistemi i leximeve*
*- Certifikata qe të konfirmojë qe APP mobile i ofertuar eshte i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh PDA*

*Nga konstatimi i dokumentacionit ne SPE dhe gjithashtu dhe nga kundershtimet e paraqitura ne ketë ankese vihet re qartësisht që <u>BOE nuk ka paraqitur certifikatën e cila te vërtetoje që APP Mobile i zgjidhjes se ofruar, është i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi</u>. Narrativa e përdorur nga operatori ekonomik ankimues ne ankese nuk vërteton përmbushjen e kriterit. Sjellim ne vëmendje që është detyrim i operatorit ekonomik qe te ngarkoje ne SPE te gjithe dokumentacionin ligjor te kërkuar ne permbushje te kritereve te parashikuara ne DST. Rikujtojmë gjithashtu qe operatori ekonomik ka patur momentin procedurial për të kërkuar sqarime nese sdo e kuptonte menyrën e plotësimit te kriterin dhe nëse ka qene i konfuzuar. Ne mungese te dokumentacionit te tille (katallogje) teknik, KVO e ka te pamundur te bej perputhshmerine e kerkesave te teknologjive te ofertuara me ato në kërkesa.*
*Për me shume vërejme se, OE në ofertën teknike nuk ka përcaktuar asnjë te dhënë për produktet që do te ofrohen, ndërkohe qe ne listen e katallogjeve të produkteve te ofruara gjenden vetem ato për sistemet al-billing (Al Billing_Prezantim_& Katalog) dhe J-billing (J- Billing Katalog dhe_Manual) te cilat jane edhe 2 produkte zëvendesuese, duke bere oferten edhe referuar sistemit te faturimit te paqartë lidhur me cfare funksioni do te ketë konkretisht ne projekt sistemi j-billing dhe cfare produktesh do te ofrohen per secilen nga kërkesat?*
*Pra referuar ofertës se OE, per seicilin nga produktet standard/te gatshme si:*

- *dafabase,*
- *partitioning*
- *Audit Log,*
- *Sistem BI,*
- *Sistemi i leximeve*

*KVO e ka te pamundur te evidentoje zgjidhjen e ofruar, prodhuesin, modelin, versionin apo opsionet dhe jo me konfigurimet dhe funksionalitetet e mundeshme.*
*Sa me sipër, kërkesa e operatorit ekonomik nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk pranohet."*

II.24. Në datën 29.08.2025 është protokolluar në Komisionin e ProkurimIT Publik me nr. 2244/4 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimues "Primus" shpk me nr. 61 prot., datë 28.08.2025 me objekt: "*Shkresë me argumenta kundërshtuese lidhur me vendimin e KSHA/AK për procedurën e prokurimit referencë REF-20140-09-17-2024*".

II.8. Me qëllim shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK, nëpërmjet shkresës nr. 2244/5 prot., datë 04.09.2025 me objekt: *"Kërkesë për paraqitje dokumentacioni",* Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të KVO-së, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke qënë se ky dokument mungonte në materialin e dorëzuar më parë nga AK në KPP.

II.9. Në datën 15.09.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.2244/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me Nr.K-2363/1 Prot, datë 11.09.2025 me objekt; "*Kthim përgjigje dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit*", bashkëngjitur procesverbali i KVO-së për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të araqitura në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Në datën 17.09.2025 Komisioni i Prokurimit Publik ripublikoi Formularin për Publikim me nr. 2244/10 prot., me të gjitha arsyet e skualifikimit të BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

## III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

**Arsyeton**

III.1. Lidhur arsyen e skualifikimit te BOE ankimues se: "*ne bazë te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE nga anëtari i BOE Primus Albania shpk është personi Denisa Sala e cila del ne pah si individ me kompetenca perfaqesuese per shkak te te gjithe dokumentacionit te firmosur nga ana e saj. Vete operatatori ekonomik ankimues e konfirmon ne argumentat e tij qe Denisa Sala ka firmosur cdo dokument, deklarate dhe formular te kesaj procedure si person me kompetenca perfaqesuese. Duke patur parasysh që dokumentacioni i ngarkuar ne SPE eshtë dokumentacion ligjor në vetvete këto mund të nënshkruahen vetëm nga administrator qe eshte perfaqesuesi ligjor i operatorit ekonomik ose nga nje person tjeter i cili e merr kete tager nga administratori. Per nje qartësim sa me te plotë sjellim ne vëmendje qe deklarate ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit parashikon që operatori ekonomik duhet te deklarojë dhe personin qe ka kompetenca përfaqesuese dhe rasti i sipërcituar eshte rast tipik i nje personi me kompetenca perfaqesuese per operatorin ekonomik dhe është detyrimi i OE deklarimi i këtij personi ne formularin permbledhes te vetedeklarimit. Fakti që nuk e ka vetedeklaruar personin Denisa Sala verteton qe formulari permbledhes per kete seksion nuk është plotësuar sipas parashikimeve ligjore. Referuar më shumë seksioneve të vete deklarimit si p.sh në seksionin B Znj. Denisa Sala vetedeklarohet:*

- *Seksioni B, "Ne cilesinë e* ***përfaqesuesit te operatorit*** *...';*
- *Seksioni C 'Ne cilesinë e operatorit ..." si dhe 'Unë jam në dijeni të kerkesave të ligjit ..' si dhe më shumë ne fund te seksionit C përcaktohet ... dhe ne ketë deklarate, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik* ***që unë perfaqësoj këtu****.'*
- *Seksioni D, "Ne* ***cilesinë e operatorit ekonomik****, deklaroj në përgjegjesine time të plotë*
- *Pjesa III, Seksioni B, "Ne* ***cilesine e operatorit ekonomik****, deklaroj ne* ***përgjegjësine time te plotë*** *.."*

*Nderkohe verejme qe formulari i vetedeklarimit te OE eshte nenshkruar nga Znj. Sala dhe pa asnje reference autorizimi ose percaktimi te ngjashem.*
*Referuar argumentive per arsyen e skualifikimit sipas se cilës BOE "Primus Albania"Shpk dhe Nexia Albania Consulting" shpk nuk kanë plotesuar Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit me konkretisht seksionin "Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi" sipas parashikimeve ligjore pasi nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi, konstatojme qe dhe ne kete rast argumentat jane narrative dhe te pashoqeruara me fakte dhe prova",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Operatorët ekonomikë "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK, kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të marrëveshjes bashkim shoqërish datë 16.12.2024, për të ofertuar së bashku në procedurën e prokurimit të publikuar nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a, me Nr.REF-20140-09-17-2024, dhe objekt: "*Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta,*

*mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve*". Kjo kontratë rezulton e nënshkruar nga palët dhe konkretisht "Primus Albania" SHPK është përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv znj.D.Sala me nënshkrimin e saj dhe "Nexia Al Consulting" SHPK, përfaqësuar nga administratori z.K.Hodaj, me nënshkrimin e tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.P.P konstaton se në marrëveshjen e bashkëpunimit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, neni 3 "Përfaqësimi" është përcaktuar se:

3.1 Z. Kreshnik Hodaj, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë Nexia Al Consulting sh.p.k., emëron përfaqesues të posaçëm Znj. Denisa Sala, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Primus Albania sh.p.k., të cilës i jep të drejtë dhe kompetenca të plota për ta përfaqësuar në tenderin me objekt: "Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve".

3.2 Pra, përfaqesues i bashkimit të shoqërive për dorëzimin e ofertës, negocimin e kontratës dhe nënshkrimin e saj, në rast se oferta shpallet fituese, është Primus Albania sh.p.k., perfaqesuar nga Znj. Denisa Sala.

Ndërsa neni 4 "Përqindja e pjesëmarrjes në bashkimin e shoqërive", ka parashikuar që shoqëria "Primus Albania " SHPK do të mbulojë 80% të angazhimit të kontratës kryesore me autoritetin kontraktor ndërsa shoqëria "Nexia Al Consulting" do të do të mbulojë 20% të angazhimit të kontratës kryesore me autoritetin kontraktor.

Në pikën 4.2 të nenit 4, është paraqitur tabela me ndarjen e detajuar të punëve/shërbimeve dhe ofrimi i tyre për secilin operator ekonomik,pjese e BOE-së.

III.1.2. Në shtojcën 8, "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit", është përcaktuar:

*Shtojca 8.*

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

***FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT***

*1.* ***KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT***

*Ofertuesi deklaron se:*

*a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*

*c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*

*ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
*d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*
*dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*
*e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
*f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
*g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
*gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
*h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
*i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomikt në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.*

*Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*

***Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.***

*Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.*

*Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :*

- *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*

- *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

*Shënim:Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë UKT sh.a dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*
*Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar i pari janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës janë krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe deklaratën për caktimin e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë.*

III.1.3. Ndërsa, në shtojcën 8, tek "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*1. Ofertuesi duhet të paraqesë:*
*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

III.1.4. Në shtojcën 9 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, gërma "A" Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit të DT-së është përcaktuar:
*Shtojca 8*

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*

*Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________ të operatorit ekonomik _______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:*

*Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit*

*A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT*

| *Deklarata* |
|---|

| |
|---|
| *Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| *Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| *Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*<br>____________________________________________________<br>____________________________________________________<br>*etj.*<br>*nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| *Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| *Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| *Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| *Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.*<br>*Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |

| |
|---|
| *Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| |
| *Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| *Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* __________________________________________________ |
| *Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.*<br>*Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| *Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.*<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |

III.1.5. Nga verifikimet e kryera nga KPP në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se secili nga anëtarët e BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK ka dorëzuar në SPE shtojcën 9 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*".

III.1.6. Në nenin 76 *"Kriteret detyruese për skualifikim"* të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:*

*a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*

*b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*

*c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
*ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
*d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
*dh) falsifikim;*
*e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*
*Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.*

*2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:*
*a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;*
*b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;*
*c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;*
*ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.*

*3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:*
*a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;*
*b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja "ç", të këtij ligji;*

*c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.*
*ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;*
*d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;*
*dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;*
*e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.*
*ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kritereve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;*
*f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.*
*g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*
*gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.*
*h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.*

*4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.*

*5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të*

*rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.*

*6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.*
*Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.*
*Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.*

*7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.*

*8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.*"

III.1.7. Në pikat 1 dhe 2, të nenit 82, "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*", të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik"* përcaktohet se:

"*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave,* ***autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake*** *në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,* ***formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.*** *Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

III.1.8. Në nenin 92, të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë*

*të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

*4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet*

*e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të*

*lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.1.9. Në nenin 26 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*", pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1.Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin,*
*si më poshtë vijon:*
*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda*

*operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
*ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*
*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*
*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*
*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*
*ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
*f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*
*g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
*gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*
*h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*
*i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*
*j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëseështë rasti;*
*k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6.Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqiturnë procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj*

*duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t΄i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

III.1.10. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr.162/2022 "Për Prokurimin Publik" parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*
*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.11. Në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr.162/2022 "Për Prokurimin Publik" parashikohet se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."*

III.1.12. Në nenin 23 "*Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik*" pika "c" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" parashikohet se: "*Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione: [...] c) miraton me vendim dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit sipas rregullave të prokurimit publik;"*

III.1.13. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.
Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.14. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se në përmbushje të kriterit të parashikuar në shtojcën 8 "*Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit të Kualifikimit*", secili nga anëtarët e BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK, ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik Shtojcën 9 "*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*", ku rezulton se "*Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit",* është plotësuar si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik "Primus Albania" SHPK ka deklaruar si vijon:

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

1. Unë i nënshkruari **Denisa SALA,** në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të operatorit ekonomik **Primus Albania sh.p.k.** deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. PJESA I: INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | **Primus Albania sh.p.k.** |
| Numri NIPT/et: | **L42202028V** |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | **Rr. "Margarita Tutulani", Pallati Viridario 1, Tirane** |
| Përfaqësuesi (emri): | **Hrvoje ČABRAJIĆ – Administrator** |
| Telefoni: | **+385 99 297 6332** |
| E-mail: | info@primus.com.al |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

## A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

| **Deklarata** |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br><br>***Primus Albania sh.p.k. është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Statusi Aktiv vërtetohet nëpërmjet Ekstraktit të Thjeshtë dhe Vërtetimi për Statusin Aktiv, të cilat mund të shkarkohen në adresën e Qendrës Kombëtare të Biznesit, qkr.gov.al apo Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë.***<br><br>***Gjithashtu mund të vërtetohet në adresën e web:*** https://e-albania.al/Default.aspx ose https://www.qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br><br>***Primus Albania sh.p.k. nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Për të provuar sa më sipër do të dorëzohet vërtetimi i lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.*** |
| Personi/personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: |
| ***Administratori dhe ortaku i shoqërisë Primus Albania sh.p.k. janë:***<br><br>***Hrvoje Čabrajić – Administrator i Primus Albania sh.p.k.***<br><br>***Ortak i vetëm i shoqërisë është Primus Adriatic d.o.o.***<br><br>***Ortakët e Primus Adriatic d.o.o. janë:***<br><br>***Hrvoje Čabrajić*** |

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*

***Personat e sipërcituar, në cilësinë e anëtarit administratorit dhe ortakut të shoqërisë, nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.***

---

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*

***Primus Albania sh.p.k. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. Për të provuar sa më sipër do të dorëzohet vërtetimi i lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.***

---

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*

***Primus Albania sh.p.k. nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Kjo vërtetohet nëpërmjet Ekstraktit të Thjeshtë dhe Vërtetimi për Statusin Aktiv, të cilat mund të shkarkohen në adresën e Qendrës Kombëtare të Biznesit, qkr.gov.al apo Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë.***

***Gjithashtu mund të vërtetohet në adresën e web:*** https://e-albania.al/Default.aspx ose https://www.qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/

---

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*

***Primus Albania sh.p.k. i ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo do të vërtetohet nëpërmjet dorëzimit të vërtetimeve lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë.***

---

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

| |
|---|
| Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br><br>***Primus Albania sh.p.k. i ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Kjo do të vërtetohet nëpërmjet dorëzimit të Vërtetimit të Debisë lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.*** |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br><br>***Primus Albania sh.p.k. ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.*** |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br><br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br><br>***Primus Albania sh.p.k. nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.***<br><br>***Primus Albania sh.p.k. nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.***<br><br>***Kjo mund të vërtetohet/verifkohet në linkun e APP https://www.app.gov.al/t%C3%AB-tjera/operator-ekonomik-t%C3%AB-p%C3%ABrjashtuar/***<br><br>***ose në Buletinin e APP nr. 87, datë 16.12.2024.*** |

Operatori ekonomik “Nexia Al Consulting” SHPK ka deklaruar si vijon:

## FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

1. Unë i nënshkruari **Kreshnik Hodaj,** në cilësinë e Adinistratorit të operatorit ekonomik **Nexia AL Consulting sh.p.k.** deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

## A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

| **Deklarata** |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br>***Nexia AL Consulting sh.p.k. është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Statusi Aktiv vërtetohet nëpërmjet Ekstraktit të Thjeshtë, i cili lehtësisht mund të shkarkohet në adresën e Qendrës Kombëtare të Biznesit, qkr.gov.al.*** |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br>***Nexia AL Consulting sh.p.k. nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Për të provuar sa më sipër do të dorëzohet vërtetimi i lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.*** |
| Personi/personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: |
| ***Administratori dhe ortaku i shoqërisë Nexia AL Consulting sh.p.k. janë:***<br>***Kreshnik Hodaj – Administrator i Nexia AL Consulting sh.p.k.***<br>***Ortakët e shoqërisë janë:***<br>***1. Nexia AL Sh.p.k***<br>***2. Western Balkan Alliance Sh.p.k.*** |

***Ortakët e Nexia AL Sh.p.k janë:***

***1. Orjana Kalaja***

***2. Western Balkan Alliance Sh.p.k***

***Ortakët Western Balkan Alliance Sh.p.k janë:***

***1. Silvana Kuqo***

---

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*

***Personat e sipërcituar, në cilësinë e anëtarit administratorit dhe ortakut të shoqërisë, nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.***

---

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*

***Nexia AL Consulting sh.p.k. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. Për të provuar sa më sipër do të dorëzohet vërtetimi i lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.***

---

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*

***Nexia AL Consulting sh.p.k. nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Kjo vërtetohet nëpërmjet Ekstraktit të Thjeshtë i cili mund të shkarkohet lehtësisht në adresën e Qendrës Kombëtare të Biznesit, qkr.gov.al***

***Gjithashtu mund të vërtetohet në adresën e web:*** https://e-albania.al/Default.aspx ose https://www.qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/

---

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*

| |
|---|
| ***Nexia AL Consulting sh.p.k. i ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo do të vërtetohet nëpërmjet dorëzimit të vërtetimeve lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë.*** |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br>***Nexia AL Consulting sh.p.k. i ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Kjo do të vërtetohet nëpërmjet dorëzimit të Vërtetimit të Debisë lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.*** |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br>***Nexia AL Consulting sh.p.k. ushtron aktivitetin e saj në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.*** |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:*<br>***Nexia AL Consulting sh.p.k. nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.***<br>***Nexia AL Consulting sh.p.k. nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.***<br>***Kjo mund të vërtetohet/verifkohet në Buletitnin e APP nr. 87 datë 16.12.2024.*** |

III.1.15. Lidhur me argumentin e dhënë nga autoriteti kontraktor sa i përket personit Denisa Sala, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, është vetëdeklaruar se znj.D.Sala është me cilësinë "Drejtor Ekzekutiv" i shoqërisë "Primus Albania" SHPK dhe cdo deklarim në këtë formular është nën përgjegjësinë e plotë të saj.

Gjithashtu nga shqyrtimi i këtij formulari konstatohet se "Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit", "A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT", rezulton se nuk është deklaruar për personin në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, znj.D.Sala, në kundërshtim me sa kërkohet në këtë formular sipas të cilit: *Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik* [...] duhet të deklarohen se *nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.* Znj.D.Sala ka kompetenca përfaqësuese dhe detyrimisht duhej deklaruar në "*Shkaqet e përjashtimit", "Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit",* si më sipër cituar. Drejtori ekzekutiv i një kompanie konsiderohet person që përfshihet në kategorinë e parashikuar nga formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pra Drejtori ekzekutiv hyn te personat që duhet të vetëdeklarojnë, njësoj si anëtarët e organit administrativ, aksionarët kryesorë apo ortakët.

Për më tepër rezulton se në dokumentat e ofertës nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë dokument përfaqësimi për Drejtorin Ekzekutiv znj.D.Sala.

Gjykojmë, se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se i plotëson të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron

III.1.16. Lidhur me konstatimin e autoritetit kontraktor se "*BOE "Primus Albania"Shpk dhe Nexia Albania Consulting" shpk nuk kanë plotesuar Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit me konkretisht seksionin "Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi" sipas parashikimeve ligjore pasi nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi, konstatojme qe dhe ne kete rast argumentat jane narrative dhe te pashoqeruara me fakte dhe prova",* rezulton se nga ana e secilës prej shoqërive është deklaruar se *"Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.",* duke lënë të hapur mundësinë për sqarime nëse vlerësohet e nevojshme nga autoriteti kontraktor dhe më pas është vijuar: "*Primus Albania SHPK ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi"* dhe "*Nexia Al Consultin SHPK ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi".*Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti

kontraktor ai që duhet t'i kërkojë ***ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.*** Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2. Lidhur arsyen e skualifikimit te BOE ankimues se: "*Komisioni i vleresimit te ofertave gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik pjesmarres konstaton se:BOE nuk ka permbushur kriterin 2.8 nenpika e cila thote "Gjithashtu App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundit nga dita e shpalljes se kesaj procedure", pasi gjate verifikimit te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE nuk konstatohet qe te jete ngarkuar certifikata e cila te konfirmoje qe APP Mobile i zgjidhjes se ofruar te eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", pika 2.8 "*Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim",* të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontaktor është parashikuar shprehimisht si vijon:

*2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, lidhur me produktet softëare te gatshem duhet të paraqesë Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik per produktet standarde te ofruara si database, partitioning, Audit Log, Sistem BI, Sistemi i leximeve, etj);*

*Gjithashtu **App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA.** Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundit nga dita e shpalljes se kesaj procedure.*

Në shtojcën 6 *"Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit*", rezulton se është kërkuar si vijon:

***Shtojca 6***

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

## *FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT*

*Shërbimi që kërkohet:*

***Afatet e ekzekutimit:***

| NR | EMËRTIMI | Njesia | SASIA | AFATI lëvrimit, nga nënshkrikimi |
|---|---|---|---|---|
| **1** | *Përmirësimi dhe Përshtatja e Sistemit të Faturimit Al-Billing(ose ekuivalent)* | *Set* | *1* | ***4 muaj*** |
| **2** | *Përmirësimi dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (ëeb service) me palët e treta. Lidhja me 1 nga Bankat (*).* | *Set* | *1* | ***6 muaj*** |
| **3** | *Permiresimi dhe Implementimi i Sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA* | *Set* | *1* | ***6 muaj*** |
| **4** | *Oracle Database Enterprise Edition (Processor License, së bashku me shërbimin e Partitioning) ose ekuivalente, përfshirë shërbimet që lidhen me zbatimin dhe migrimin, dhe **shërbimet e replikimit online me bazën e të dhënave Cloud**.* | *Procesore* | *3* | ***15 dite*** |
| **5** | *Sistemim i auditimit të bazave të të dhënave Oracle si Core Audit Application (Processor License) ose ekuivalente.* | *Procesore* | *3* | ***15 dite*** |
| **6** | *Server cloud së bashku me mbrotjen e të dhënave, për zbatimin e komponenteve online me bankat si dhe me klientet (vite)* | *Vite* | *3* | ***15 dite*** |
| *7* | *Bazë e të dhënave të hostura Oracle e integruar me bazën e të dhënave në on-premise (vite)* | *Vite* | *3* | ***15 dite*** |
| **8** | *Sistemi i hostuar i raportimit BI, me një numër minimal prej 10 përdoruesish (vite)* | *Vite* | *3* | ***15 dite*** |
| **9** | *Mirëmbajtje dhe garanci prodhuesi per Sistemit të Faturimit Al-Billing(ose ekuivalent), Reader, Taksa dhe ËS të pagesave, **bazat e te dhenave enterprise edition**, **particionimit**, **core audit** për periudhë vjecare (vite) (**)* | *Vite* | *3* | ***15 dite*** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ***10*** | *Administrimi i Projektit si dhe levrimi i dokumentacioneve baze te sistemit :*<br>- *Draft rregullore per operimin e sistemit AL-Billing(ose ekuivalent);*<br>- *Draft rregullore per operimin e sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA,*<br>- *Perditesimin e Manualin te perdorimit te sistemit, dhe perditesimin e tij, pas cdo nderhyrje permiresuese ne sistem. Vecanerisht lidhur me permiresimet e planifikuara ne kete projekt. Keto manual duhet te perfshine edhe komponentet e tjere te sistemit Al-Billing(ose ekuivalent), si Sistemit Raportimit BI, Shërbimit të Pagesave (ëeb service) per shkembimin e te dhenave me Bankat, etj.;*<br>- *Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e Al-Billing(ose ekuivalent);*<br>- *Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin AL-Billing(ose ekuivalent);*<br>- *Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA;*<br>- *Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA;* | *Muaj* | *6* | ***6 muaj*** |
| ***11*** | *Trajnim i vazhdueshem i perdoruesve te sistemeve* | *Klasa* | *10* | ***36 muaj*** |

III.2.2. Në shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike", përvec të tjerave, është parashikuar si vijon:

## *2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA*

### *2.1. Objektivi i Përgjithshëm*

*[...]*

- ✓ *Permiresimi i proceseve qe lidhen me leximet e matesve, te dhenat rreth taksave, kontrolleve te cilesise se te dhenave qe mblidhen me ane te App mobile ne pajisjet mobile PDA dhe integrimet me sistemin e faturimit Al-Billing. Synimi eshte te automatizohen proceset qe e ofrojne kete mundesi, te rritet siguria dhe te unifikohen standardet me sistemin e Al-Billing, te rritet shpejtesia e funksionimit, lehtesia e perdorimit te App mobile nga lexuesit, optimizimet e integrimeve, shtimi i kontrolleve te avancuara per kontrollin e cilesise, raportim efikas. Te gjithe keto permiresime do e kryhen nepermjet nje sistemi te pershtatshem qe i ploteson kerkesat teknike e funksionale qe do te shpjegohen ne vazhdim te dokumentit.*

### *2.3. Rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nga Kontraktori*

*[...]*

- ✓ *Implementimi i nje sistemi te pershtatshem per menaxhimin e mbledhjes e leximeve kryerjes se kontrolleve dhe proceseve qe lidhen me taksat duke ofruar panelin e administrimit ne ëeb dhe App mobile per operatoret qe mbledhin te dhenat ne terren*

## *4. QËLLIMI i PUNËS*

***Permiresimi dhe Implementimi i Sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA***

*Aktualisht sistemi i administrimit te leximeve eshte nje shtese e sistemit te Al-billing persa i perket panelit te administrimit dhe ka App mobile per kryerjen e disa proceseve qe lidhen me mbledhjen e te dhenave te matesve nga operatoret ne terren. Kjo menyre funksionimi nuk ofron fleksibilitet per te kryer ndarjen e akseseve te dy sistemeve. Meqenese App mobile per PDA komunikon me Al-billing nepermjet internetit, kjo konsiderohet nje mangesi sigurie pasi App mobile eshte nje sistem jashte rrjetit te brendshem te UKT. Per te rritur sigurine keto sisteme duhet te jene te ndara. Pra Al-billing dhe sistemi i adminstrimit te leximeve duhet te jene dy sisteme te ndara qe komuikojne mes tyre nepermjet ëeb service te sigurta.*

*Ky sistem do te jete i instaluar i vecuar nga sistemi Al-Billing, ne cloud e ofertuar nga OE, meqenese ai do te komunikoje me pajisjet PDA me ane te ëeb serviceve. Kjo arkitekture kerkohet per te garantuar qe ne cdo eventualitet sulmi, te ndikohet vetem ky sistem dhe jo sistemi i faturimit Al-Billing.*

- ✓ *Sistemi te bazohet plotesisht ne teknologji ëeb lidhur me panelin e administrimit dhe te kete App mobile per operatoret qe mbledhin te dhenat ne terren.*
- ✓ *Leximet duhet te ruhen ne menyre te detajuar per ndryshimet qe administratoret e programit te kene mundesi te shikojne te dhena mbi vleren e vjeter, te re, perdoruesin dhe oren e sakte kur eshte kryer veprimi.*
- ✓ *Sistemi kryen procedura te qarta per Back Up periodik te te dhenave.*

- ✓ *Programi duhet te perdore teknika per optimizimin e perdorimit te bandes se internetit.*
- ✓ *Ne nderfaqen e administrimit perdoruesit te menaxhojne te dhenat te cilat mblidhen nga leximet ne terren, marrin raporte operacionale dhe gjithashtu reporte te ndryshme per leximet dhe raporte te tjera te nevojshme per mireorganizimin e punes.*
- ✓ *Gjate hedhjes se leximeve per abonentet programi duhet te mundesoje shtimin e problematikave ne nivel te palimituar nenkategorish. Ky informacion duhet te sherbeje per te ndertuar reporte te detajuar per te percaktuar sakte problemet qe kane abonentet dhe veshtiresite qe kane lexuesit gjate punes se tyre.*
- ✓ *Procesi i leximit duhet te mundesoje krijimin e ndarjes hierarkike zonale duke lejuar keshtu copezimin e zonave ne nen-zona me te menaxhueshme.*
- ✓ *Procesi i leximit duhet te ofroje mundesi per shtimin e nyjeve teknike ne menyre hierarkike. Tipologjia e nyjeve teknike duhet te jete dinamike per te mundesuar shtimin e metejshem. Per nyjet teknike duhet te ruhet edhe statusi ne te cilin ndodhet. Status i nyjes sherben psh: per te pare impaktin ne rast te riparimeve te ndryshme apo edhe per te gjeneruar njoftime automatike ne te ardhmen.*
- ✓ *Programi duhet te mundesoje caktimin e zonave lexuesve. Programi duhet te njoftoje ne nje zone i eshte caktuar mepare nje lexuesi tjeter ne menyre te tille qe te behet perdorimi me eficence i burimeve njerezore.*
- ✓ *Programi duhet te mundesoje percaktimin e itinerarit te leximeve per secilin lexues ne menyre kalendarike per cdo dite. Moduli duhet te siguroje shperndarjen e lexuesve ne menyre te tille qe te mos kete perplasje ndermjet tyre, nuk mund ti caktohet 2 lexuesve te njejtet abonente.*
- ✓ *Procesi i sinkronizimit duhet te jete automatik dhe real time. Programi duhet te realizoje kalim e te dhenave te marra nga lexuesit ne menyre automatike ne sistemin qendror.*
- ✓ *Nderveprimi midis aplikacionit per PDA-te dhe komponentes server te instaluar ne cloud duhet te jete i pavarur nga teknologjia e perdorur ne keto dy programe. Standarti i perdorur per komunikimin midis programeve duhet te jete psh: SOAP, REST ose ekuivalent.*
- ✓ *App mobile i PDA duhet te dergoje te dhena per vendodhje gjeografike te lexuesit ne momentin e marrjes se leximit. Te dhenat gjeografike duhet te dergohen me nje precision sa me te larte.*
- ✓ *Marrja e pozicionit gjeografik duhet te jete proces i optimizuar ne perdorimin e baterise.*
- ✓ *Marrja e pozicionit gjeografik duhet te parashikoje situatat kur lexuesit gjenden ne zona pa mbulim nga satelitet si psh: brendesia e godinave etj. Ne kete rast aplikacioni mbeshtetes duhet te raportoje vendodhjen e fundit te sakte qe ka percaktuar nga sinjali GPS.*
- ✓ *App mobile per PDA duhet te ofroje mundesine e sinkronizimit te mevonshem por gjithashtu duhet te sinkronizoje te dhenat ne kohe reale ne rastet kur gjendet ne zonat me mbulim te sinjalit celular ose ëifi.*
- ✓ *App mobile per PDA duhet te kerkoje berjen e fotografive ne cdo rast ose bazuar mbi logjiken e percaktuar nga administratori i programit ne panelin e administrimit.*

- ✓ *App mobile per PDA duhet ti shfaqe lexuesit ne menyre te qarte itenerarin e planifikuar nga menaxheret e tyre nepermjet nderfaqes se administrimit.*
- ✓ *App mobile per PDA duhet te perdore teknikat e kompresimit te informacionit per dergimin e te dhenave ne serverin qendror duke perdorur sa me pak banden e internetit.*
- ✓ *App mobile per PDA duhet te perdore teknika te verifikimit te dergimit te sakte te te dhenave ne server dhe duhet gjithashtu te perdore teknika te menaxhimit te deshtimit te lidhjes me server apo te nderprerjes se dergimit te te dhenave.*
- ✓ *App mobile per PDA duhet te perdore teknika per kriptimin e te dhenave te cilat dergon ne server duke parandaluar keshtu interceptimin e tyre nga persona keqdashes.*
- ✓ *Nderfaqja ëeb e administrimit duhet te ofroje mundesi per inventarizimin e pajisjeve PDA duke lejuar regjistrimin e informacioneve shtese per cdo pajisje si psh: status i pajisjes, personi i cili e ka ne dorezim pajisjen, version i aplikacionit te instaluar ne PDA etj.*
- ✓ *Nderfaqja ëeb e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen e fotografive te ngarkuara ne program nga aplikacioni per PDA.*
- ✓ *Per cdo leximi te raportuar ne program ne nderfaqen e administrimit duhet te jepet mundesia e paraqitjes ne harte te pozicionit te lexuesit ne momentin e leximit.*
- ✓ *Nderfaqja ëeb e administrimit duhet te ofroje reporte per nxjerrjen e variacionit te distances nga abonenti ne momentin e leximit te matesit.*
- ✓ *Nderfaqja ëeb e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen ne harte te itinerarit te nje lexuesi ne nje segment kohor te caktuar.*
- ✓ *Sinkronizimi i te dhenave duhet te perdore teknika te menaxhimit te situatave te konkurences per te evituar rastet e bllokimit te ndersjellte (deadlocks).*
- ✓ *App mobile i PDA duhet te realizoje perditesimin e vetes nepermjet internetit pa perdorur sherbimet e Google Play ose ekuivalent.*
- ✓ *App mobile i PDA duhet te ruaje log-e te aktivitetit te perdoruesit dhe duhet te mund ti dergoje keto ne server ne momentin e dergimit te kerkeses nga server.*
- ✓ *App mobile i PDA duhet te implementoje mesazhet push te cilat mundesojne kryerjen e nje sere aktivitetesh ne PDA pa nevojen qe perdoruesi te kryeje ndonje veprim. Ky funksionalitet lehteson administrimin nga stafi qendror i IT te shoqerise dhe shmang lexuesin nga njohja me funksionalitetet teknike.*
- ✓ *App mobile i PDA duhet te ndryshoje automatikisht oren dhe daten e sistemit lokal duke bere te mundur sinkronizimin e ores dhe dates me oren dhe daten e server qendror.*
- ✓ *App mobile te instalohet ne aparatura PDA me sistem operimi Android versione te ndryshme meqenese kete PDA ekzistuese te UKT apo qe mund te prokurohen ne vijim mund te perdorin versione te ndryshme te sistemit te operimit Android.*
- ✓ *App mobile per PDA duhet te jete i optimizuar per te funksinouar me pajisje mobile te tipit PDA dhe te perdore ne menyre optimale burimet e saj ku nje nder burimet kryesore eshte energjia e baterise se PDA*
- ✓ *Saktësimi i sigurisë së aksesimit të sistemit nga përdoruesit duke shtuar 2FA*

- ✓ *Përmirësimi i funksionit për të përcaktuar Location te kontratës në mënyrë qe te mund te percaktojme zonen fiskale te sakte sipas te ciles te behet perllogaritja e takses se baneses.*
- ✓ *Percaktimi i burimit te informacionit mbi vetedeklarimin e takses se baneses.*
- ✓ *Te ofrohet raport per perjashtimet, rivendosjet te taksave.*
- ✓ *Te ofrohet raport mbi faturimin e taksave dhe tarifave vendore.*
- ✓ *Te ofrohet raport mbi arketimin e taksave dhe tarifave vendore.*
- ✓ *Te ofrohet raport mbi debine e taksave dhe tarifave vendore.*
- ✓ *Administrimi i formave të regjistrimit nga grupet e punës në terren*
- ✓ *Raportimi i faturimit në numrin e leximeve si dhe sasinë m3 referuar lexuesëve si dhe zonave*
- ✓ *Regjistrimi i të dhënave për verifikimin e ndërtesës së abonentëve duke bërë kontrollin e pikës në terren*
- ✓ *Raportimi i formularit të deklarimit të ndërtesës dhe vendosjes së taksës së ndërtesës sipas zonës dhe sipërfaqes që ajo mbulon.*
- ✓ *Ruajtja e historikut të ndryshimeve të informacionit*
- ✓ *Komunikimi dytrejtimor nepermjet ëeb service SOAP ose REST, nepermjet https, me sistemin e faturimit Al-billing per te automatizuar proceset e marrjedhe dhe dhenies se te dhenave. Ky komunikim te zbatoje parimet e sigurise pe rte shmangur nderhyrjet e pa aurotizuara.*
- ✓ *Sistemi te mos lejoje akses ne bazen e te dhenave te perdoreusve te pa autorizuar.*
- ✓ *Baza e te dhenave te kete te konfiguruar perdoruesit me privilegjet minimale qe i duhet per te kryer detyrat e veta, si per perdoruesit e vet sistemit dhe atyre te jashtem qe mund te duhen per shkak te punes se specialisteve te UKT ose sistemeve te tjera qe mdun te duan akses direkt ne bazen e te dhenave.*
- ✓ *Sistemi te jete e mundur te instalohet si ne sistem operativ Linux ashtu edhe Ëindoës ose ekuivalent me keto.*
- ✓ *Programi duhet te kete mundesine e krijimit te nje llogarie per secilin perdorues. Te dhenat e nevojshme per te krijuar nje llogari jane:*

  *· Emri - Emri i perdoruesit*

  *· Mbiemri – Mbiemri i perdoruesit*

  *· Perdoruesi - Emri me te cilin programi identifikon kete perdorues.*

  *· Email - Adresa e -mail e perdoruesit*

  *· Fjalekalimi - Fillimisht, vendoset nje fjalekalim standard, pastaj secili perdorues mund ta vendose ate te personalizuar.*

  *· Roli - Roli qe perdoruesi do te kete ne program*

*· Statusi – Statusi i perdoruesit aktiv/jo aktiv. Ne momentin e krijimit te perdoruesit te jete automatikisht aktiv*

- ✓ *Bazuar ne rolin qe i eshte caktuar nje perdoruesi, kur krijohet nga Administratori i sistemit, te shfaqet nje nderfaqe specifike per rolin qe ai ka dhe qe i lejon atij te kryeje veprimet qe i takojne.*
- ✓ *Programi te ofroje opsione privilegjesh dhe politika aksesi per perdoruesit, rolet, leximin-shkrimin, vetem leximin, modifikimin etj. Programi te ofroje mekanizma te ndryshem vertetimi dhe mundesi te shumta sigurie.*
- ✓ *Programi te aplikoje politikat e aksesit mbi modulin; menune; nen-menune; skedarin, dokumentin ose objektin, veprime te caktuara, etj.*
- ✓ *Programi te aplikoje nivele te shumta te te drejtave te aksesit (Fshi / Modifiko / Shiko / Ngarko / Shkarko, etj.).*
- ✓ *Programi te mundesoje qe opsionet te jene dinamike sipas perdoruesve - per shembull, grupe te ndryshme mund te shikojne rekorde te ndryshme ne te njejten nderfaqe.*
- ✓ *Programi te mundesoje ndryshimin e dukshmerise/shfaqjes ne menyre dinamike ne nderfaqet.*
- ✓ *Programi te siguroje aftesine per te gjeneruar raporte per te gjitha nivelet e perdoruesve dhe skedareve.*
- ✓ *Programi te mundesoje qasje te kufizuar per perdorues te caktuar.*
- ✓ *Çdo veprim ne program te regjistrohet (permes logs) duke percaktuar qarte perdoruesin, kohen e veprimit (kohezgjatjen), llojin e veprimit (lexim, ndryshim, perditesim), te dhenat e ndryshuara, IP-ne e perdoruesit, etj.*
- ✓ *Programi te siguroje nderfaqet perkatese per paraqitjen e logs si dhe mundesine per filtrimin e tyre, per gjurmim te shpejte.*
- ✓ *Programi te siguroje aftesine per te gjurmuar per qellime auditimi, madje edhe objektet e bazes se te dhenave per veprimet qe manipulojne informacionin: krijimin, modifikimin dhe fshirjen ne nivelin e perdoruesit dhe skedarit.*
- ✓ *Ndryshimi i fjalekalimit nga perdoruesit te kryhet permes mekanizmave te cilat mundesojne siguri maksimale.*
- ✓ *Kodi burimor i programit duhet te ruhet ne nje sistem versionimi GIT/SVN/CVS ose ekuivalent. Aplikimi dhe menaxhimi i shtimeve apo modifikimeve te funksionaliteteve duhet te behet sipas procedurave operative te mirepercaktuara e transparente me AK-ne te cilat duhet te perfshijne plane per rikthimin ne gjendjen e meparshme te sistemit ne rast deshtimi.*
- ✓ *Licensa e perdorimit te programit gjate gjithe shtrirjes se kontrates sipas kohezgjatjes dhe kerkesave percaktuar ne keto terma reference duhet te jete e evidentuar edhe ne Aplikacion mobile dhe nderfaqen e administrimit.*

*[...]*

III.2.3. Sipas ankimuesit kundërshtohen argumentat e autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon: "*Për të përmbushur kriterin 2.8 BOE ka paraqitur katalogë Al Billing - Sistem Menaxhimi Informacioni për ujësjellësa, si dhe Catalog prezantimi Manual përdorimi mbi sistemin: "Js Billing". Programi kompjutertk i faturimit është i vetmi soft që kërkoni të mirëmbani dhe përmirësoni dhe për këtë ne kemi depozituar katalogët. Softi i PDA është një soft integral i vetë pajisjeve, i cili ashtu sic funksionon sot është kompatibël me programin e faturimit Al-Billing. Në katalogët/ manualët tanë (pasi katalogët shërbejnë përgjithësisht për hardëare dhe softëare) janë përcaktuar qartë ndërtimet dhe funksionimet e tyre, si dhe në vecanti lidhja dhe bashkëveprimi i tyre me sistemet e leximit UK Reader (PDA).*
*App Mobile Ukreader është një aplikacion Android i cili lidhet me ukreader Ëeb me anë të REST API. Cdo system Android mund të përdorë këtë aplikacion. Duke marrë parasysh që komunikimi kryhet me anë të API me Aplikacionin e hostuar në server on premise dhe App Mobile është një aplikacion i ndërtuar për sistemin Android e bën përdorimin e tij të mundur në një game shumë të gjerë pajisjesh android ose PDA".* Pra, referuar pretendimeve të paraqitura nga ankimuesi, konstatohet se nga ana e tij nuk mohohet fakti i mungësës së certifikimit të App mobile i sistemit te leximeve nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA, dhe nuk sqarohet në asnjë moment arsyeja e këssaj mungese.

III.2.4. Në vendimin e KSHA për ankesën e paraqitur nga BOE ankimues, është gjykuar se: *Referuar argumenteve te paraqitur ne ankesë nga operatori ekonomik ankimues dhe dokumentacionit te ngarkuar ne SPE lehtesisht konstatohet qe OE nuk ka paraqitur dokumentacionin e parashikuar ne kriterin 2.8. Ne nje analize dhe shtjellim te kriterit 2.8 "Operatori ekonomik pjesëmarres, lidhur me produktet softeare te gatshem duhet te paraqese materiale teknike te prodhuesit (katalog teknik per produktet standarde te ofruara si* ***database, partitioning, Audit Log, Sistem BI, Sistemi i leximeve****, etj), Gjithashtu App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtaishem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundii nga dita e shpalljes se kesaj procedure" qartësisht konstatohet qe ky kriter permbushet me paraqitjen ne SPE te dokumentave si më poshte:*
- *Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik për produktet standarde të ofruara si database, partitioning, Audit Log, Sistem BI, Sistemi i leximeve*
- *Certifikata qe të konfirmojë qe APP mobile i ofertuar eshte i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh PDA*

*Nga konstatimi i dokumentacionit ne SPE dhe gjithashtu dhe nga kundershtimet e paraqitura ne ketë ankese vihet re qartësisht që BOE nuk ka paraqitur certifikatën e cila te vërtetoje që APP Mobile i zgjidhjes se ofruar te eshtë i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Narrativa e përdorur nga operatori ekonomik ankimues ne ankese nuk vërteton përmbushjen e kriterit. Sjellim ne*

*vëmendje që është detyrim i operatorit ekonomik qe te ngarkoje ne SPE te gjithe dokumentacionin ligjor te kërkuar ne permbushje te kritereve te parashikuara ne DST. Rikujtojmë gjithashtu qe Operatori ekonomik ka patur momentin procedurial për të kërkuar sqarime nese sdo e kuptonte menyrën e plotësimit te kriterin dhe nëse ka qene i konfuzuar. Ne mungese te dokumentacionit te tille (katallogje) teknik, KVO e ka te pamundur te bej perputhshmerine e kerkesave te teknologjive te ofertuara me ato në kërkesa.*

*Për me shume vërejme se, OE në ofertën teknike nuk ka përcaktuar asnjë te dhënë për produktet që do te ofrohen, ndërkohe qe ne listen e katallogjeve të produkteve te ofruara gjenden vetem ato për sistemet al-billing (Al Billing_Prezantim_& Katalog) dhe J-billing (J- Billing Katalog dhe_Manual) te cilat jane edhe 2 produkte zëvendesuese, duke bere oferten edhe referuar sistemit te faturimit te paqartë lidhur me cfare funksioni do te ketë konkretisht ne projekt sistemi j-billing dhe cfare produktesh do te ofrohen per secilen nga kërkesat?*

*Pra referuar ofertës se OE, per seicilin nga produktet standard/te gatshme si:*

- *dafabase,*
- *partitioning*
- *Audit Log,*
- *Sistem BI,*
- *Sistemi i leximeve*

*KVO e ka te pamundur te evidentoje zgjidhjen e ofruar, prodhuesin, modelin, versionin apo opsionet dhe jo me konfigurimet dhe funksionalitetet e mundeshme."*

III.2.5. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 "*Për prokurimin publik"* parashikohet se: "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."*

III.2.6. Në nenin 3 të ligjit 162/2020 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se: "*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."*

III.2.7. Në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*"

III.2.8. Në nenin 92 te ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*
*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*
*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin

certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.10. Nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga BOE ankimues në SPE, rezulton se nuk është paraqitur asnjë certifikatë qe të konfirmojë qe APP mobile i ofertuar eshte i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh PDA, në kundërshtim me kërkesën e autoritetit kontraktor sipas të cilit "*App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundit nga dita e shpalljes se kesaj procedure*". Gjithashtu konstatohet se në ankesën e paraqitur, nga ana e ankimuesit nuk mohohet fakti i mungësës së certifikimit të App mobile i sistemit te leximeve nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA, dhe nuk sqarohet në asnjë moment arsyeja e kësaj mungese.

Në këtë kuptim KPP gjykon, se BOE objekt shqyrtimi është në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon certifikimit të APP mobile të ofertuar.

KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.2.11. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se BOE ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", parashikohet se *"[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*
*Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]*".
Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.3. Së fundi, KPP konstaton se në kthim përgjigjen drejtuar ankimuesit KSHA ka shtuar pretendime/arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues të cilat nuk i janë komunikuar në momentin e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga KVO. Konkretisht janë shtuar arsye skualifikimi si vijon:
***"****Për me shume vërejme se, OE në ofertën teknike nuk ka përcaktuar asnjë te dhënë për produktet që do te ofrohen, ndërkohe qe ne listen e katallogjeve të produkteve te ofruara gjenden vetem ato për sistemet al-billing (Al Billing_Prezantim_& Katalog) dhe J-billing (J- Billing Katalog dhe_Manual) te cilat jane edhe 2 produkte zëvendesuese, duke bere oferten edhe referuar sistemit te faturimit te paqartë lidhur me cfare funksioni do te ketë konkretisht ne projekt sistemi j-billing dhe cfare produktesh do te ofrohen per secilen nga kërkesat?*
*Pra referuar ofertës se OE, per seicilin nga produktet standard/te gatshme si:*
- *dafabase,*
- *partitioning*

- *Audit Log,*
- *Sistem BI,*
- *Sistemi i leximeve*

*KVO e ka te pamundur te evidentoje zgjidhjen e ofruar, prodhuesin, modelin, versionin apo opsionet dhe jo me konfigurimet dhe funksionalitetet e mundeshme."*

III.3.1. Në nenin 80 të Ligjit nr.162 date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se: *"1. Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:*
*a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;*
*b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.*
*2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.*
*3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi*
*4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj*

III.3.2 Në nenin 82 pika 2 të Vendimit nr.285 të Këshillit të Ministrave datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, parashikohet se *". Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. "Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. "Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. "Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë."*

III.3.3. Në nenin 113, pika, të ligjit nr.162/2020, dt. 23.12.2020 "Për prokurimin publik" është parashikuar: "*1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për*

*përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.*

*2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.*

III.3.4. Në kreun X *"Zhvillimi i Procedurave "*, neni 101, te Vendimit nr.285 të Këshillit të Ministrave datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar parashikohet se *"Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti/enti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: 1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, me urdhër të veçantë, cakton një person ose ngre një komision të përbërë nga të paktën 3 (tre) persona për shqyrtimin e ankesës. Të paktën njëri nga anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesës duhet të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave ose ekspertit të fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave."*

III.3.5. Gjithashtu ne nenin 94 të Vendimit nr 285 të Këshillit te Këshillit të Ministrave dt. 19.05.2021 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar parashikohet se:

1. *Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 2. Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. 3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar. Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.*

III.3.6. Në nenin 102 pika 1 të Vendimit Nr.285 të Këshillit të Ministrave dt. 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikohet se: *[...]1. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla,*
*autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë:*
*a) pranimin e plotë të ankesës;*
*b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
*c) refuzimin e ankesës.*
*2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
*3. Vendimi i autoritetit/entit kontraktor u komunikohet të gjitha subjekteve të përfshira në proces..*

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara proceduriale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 4 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 3 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri mer normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet proceduriale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë proceduriale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor ( rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A ( Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 113 i ligjit nr.162 datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik" të ndryshuar*, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së.

Në rastin konkret KPP konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës ka vendosur mospranimin e ankesës së BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK si dhe ka shtuar arsye të reja skualifikimi në tejkalim të kompetencave që parashikon ligji.

III.3.8. Sa më sipër Komisioni gjykon se arsyet e reja të skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni Neni 94 i VKM nr.285 datë 19.05.2021, nuk sjellin asnjë pasojë mbi BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi ankimuesi nuk përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19",* Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK në procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*", me Nr.REF-20140-09-17-2024, me objekt: "*Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve*", me fond limit 144.043.333,3 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AL Consulting" SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Anëtar | Anëtar | Anëtar |
| --- | --- | --- |
| **Anila Malaj** | **Kreshnik Ternova** | **Gjergj Mersini** |

**Nënkryetar**
**Fiorent Zguro**

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2025.10.06
12:42:00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2025/10/06 12:20:30 +02'00'
4c238ba22b5c4b2aafc2590ff0fde4b32025100612
202179020

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*